



REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 638/24 Dt. 14.10.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), nenit 21 të Ligjit nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve, nenit 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) –Nr. 23/2023 për Procedurat e Punës në Tryezat MultiDisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për Themelimin e Tryezës MultiDisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit

1. Themelohet Tryeza MultiDisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit në Komunën e Prizrenit.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Tryeza MultiDisiplinare për Ndhimë në Menaxhimin e Rastit, ka këtë përbërje:
 - 2.1. Menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale,
 - 2.2. Ndhimës menaxheri i rastit nga Qendra për Punë Sociale,
 - 2.3. Zyra për Mbrojtjen dhe Ndhimë të Viktimave –Mbrojtës i Viktimave,
 - 2.4. Shërbimi Sprovues i Kosovës-zyrtar i Shërbimit Sprovues,
 - 2.5. Qendra e Mjekësisë Familjare –mjek specialistë sipas specifikave të rastit,
 - 2.6. Policia e Kosovës,
 - 2.7. Qendra për Shëndet Mendor-specialist i fushës për trajtimin e fëmijëve,
 - 2.8. Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës-zyrtar për Arsim,
 - 2.9. Drejtoria për Punës dhe Mirëqenie Sociale-zyrtari përgjegjës,
 - 2.10. Psikologu/Punëtori Social/Pedagogu i Shkollës ose përfaqësues i deleguar nga institucioni edukativo-arsimor,
 - 2.11. Zyra për Komunitete dhe Kthim-zyrtar për Komunitete,
 - 2.12. Institucioni për Strehim Përkujdesës ose familja strehuese,
 - 2.13. Zyra për të Drejtat e Njeriut-zyrtari për të Drejtat e Njeriut/Fëmijës,
 - 2.14. Përfaqësues të Organizatave Joqeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijës.

3. Tryeza Multidisiplinare është nën udhëheqjen e menaxherit të rastit dhe ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- 3.1. trajton rastet specifike të abuzimit, keqtrajtimit të fëmijës dhe lënien pasdore në bazë të interesit më të mirë të fëmijës;
- 3.2. përcjell dhe në vazhdimësi rishqyrton vlerësimin e rastit të bërë paraprakisht nga menaxheri i rastit, duke plotësuar me informata të përditësuara varësisht nga ndryshimi i gjendjes së fëmijës apo rrethanave në rast;
- 3.3. bashkërendon dhe zhvillon procesin e planifikimit të përbashkët të veprimit për mbrojtje të fëmijës në përputhje me rrethanat dhe me legjislacionin përkatës në fuqi;
- 3.4. koordinon ofrimin e shërbimeve për mbrojtje, rehabilitim dhe integrim apo riintegrim të fëmijës, në mënyrë të qëndrueshme dhe përkrah familjet e tyre ose kujdestarin;
- 3.5. rishikon planin individual për mbrojtjen e fëmijës në baza mujore, në raste specifike edhe më shpesh;
- 3.6. harton raportin vjetor për punën e vet dhe raporton tek Komuna dhe sipas kërkesës edhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit për të Drejtat e Fëmijës.

4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Anëtarëve,
 - Arkivës së Kryetarit.